


Bisedë me udhëheqësin e "Wus Austria" në Kosovë, But Dedaj

Në agjendë, "kthimi i trurit"

Prishtinë, 8 mars - Zhvillimi i lëndëve si dhe i metodologjive të reja të mësimdhënies për lëndët ekzistuese në Universitetin e Prishtinës (UP) e ka përafruar publikun edhe një hap drejt plotësimit të standardeve arsimore evropiane. Tash e tetë vjet kjo traditë ndiqet në UP, me financimin e organizatës për ndihmë arsimit "Wus Austria", e cila lëndët e reja që propozohen nga profesorët dhe miratohen nga paneli vlerësues, i përbërë kryesisht nga ekspertë austriakë, i mbështet edhe me pajisje laboratorike. Profesorët e UP-së, krahas vizitës studimore që zhvillojnë jashtë vendit në universitetet dhe institutet shkencore, ndihmohen nga "Wus Austria" të blejnë pajisje konkretizuese deri në 15 mijë euro, përderisa pjesa tjeter deri në 30 për qind mbulohet nga UP-ja, që do të thotë se lejohet të blihet një pajisje prej 22-23 mijë eurove



për ato lëndë.

Udhëheqësi i "Wus Austria"-s në Kosovë, But Dedaj, në një bisedë për "Lajm" thotë se deri më tash në UP janë implementuar 33

lëndë të reja, ndërsa për periudhën e ardhshme trevjeçare do të mbështetet edhe inkuadrimi i mbi 20 lëndëve tjera të reja. "Përzgjedhja e lëndëve bëhet me iniciativën e profesorit, sepse lëndën e re është përgjegjës për ta zbatuar vetëm profesori. 'Wus Austria' e shpall konkursin, aplikacionet dërgohen në Austria, e më pas vlerësohen nga komisioni austriak nëse mbështeten apo jo". Dedaj thotë se nga 12 aplikacione të dorëzuara në muajin shkurt janë mbështetur gjashtë lëndë, prej të cilave katër me pajisje për Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore. "Në maj do të shpallet dhe faza e dytë e aplikimit, ndërsa faza e tretë do të organizohet në shkurt apo prill të vitit 2010".

Përveç kësaj, "Wus Austria" është duke e implementuar edhe programin "Kthimi i Trurit", që ka për qëllim ti stimulojë kuadrot nga

Kosova të shkolluara jashtë të vijnë dhe të mbajnë cikël të ligjératave në UP, prej një deri në tri javë. Dedaj thotë se nëpërmjet këtij programi është arritur deri më tash të sillen në vend 55 ekspertë të ndryshëm nga Austria, që kanë kryer doktorata atje. "Një pjesë e këtyre profesorëve që kanë ardhur nëpërmjet këtyre programeve kanë krijuar marrëdhënie të rregullt pune në Kosovë, qoftë në UP apo jashtë, përfshirë drejtorë të departamenteve nëpër ministri të ndryshme, zëvendësministra, profesorë të UP-së dhe ekspertë eminentë që punojnë nëpër institucionë të ndryshme të Kosovës". Një program tjetër, që sipas Dedajt është tejet i rëndësishëm për UP-në dhe një risi edhe përsistemin arsimor, janë katër master programe komplet të reja që do të hapen në fillim të vitit të ri akademik. Në Fakultetin Juridik do të hapen master për të drejtën

pronësore civile dhe për të drejtën ndërkombëtare. Masteri i tretë do të jetë Mekatronika me bashkimin e dy fakulteteve; Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe masteri tjetër në Menaxhim Shëndetësor. "Studimet master në këto drejtime do të organizohen në bashkëpunim të ngushtë me universitet austriake, ndërkëq profesorë nga Austria do të vijnë të mbajnë mësim në UP". "Wus Austria" funksionon në Kosovë që nga viti 1998, si më e vjetra organizatë dhe e vëtmja që e ka njojur UP-në gjatë funksionimit paralel të arsimit, ndërkëq pas luftës ka kryer projekte me rëndësi të madhe në plotësimin e kushteve dhe afromin e universitetit të vetëm publik me standartet e institucioneve të arsimit të lart evropian. (a. kadrri)

"LAJM", 09/03/2009